**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MASHT) NR: 17/2014 APLIKIMI I PAGESAVE TË STUDENTËVE NË UNIVERSITET PUBLIKE**

**ADMINISTRATIVE INSTRUCTION (MEST): NO 17/2014 APPLICATION OF STUDENTS' PAYMENT IN PUBLIC UNIVERSITIES**

**ADMINISTRATIVNA UREDBA (MONT):BR. 17/2014 APLIKACIJA STUDENTSKIH ISPLATA NA DRŽAVNIM UNIVERZITETIMA**

| | | |
|---|---|---|
| Në bazë të nenit 30 paragrafi 1 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 14/9 shtator 2011 dhe duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011 (Gazeta zyrtare nr. 15, 12.09.2011), nxjerr: | Pursuant to article 30 paragraph 1 of the Law for Higher Education in Republic of Kosovo no. 04/L-037, date 29 August 2011 and being based in article 8, paragraph 1.4 and appendix 6 of Regulation no. 02/2011 for fields of administrative responsibility of Prime Minister's Office and Ministries (22.03.2011), and article 38 paragraph 6 0f the Government's Rule of Procedure no. 09/2011 (official gazette no. 15. 12.09.2011) , issues: | Na osnovu člana 30 stav 1 Zakona o visokom obrazovanju u Republiku Kosova br. 04/Z-037 dana 29 avgust 2011 i na osnovu člana 8 stav 1.4, prilog 6 Pravilnika br. 02/2011 za oblasti administrativne odgovornosti Kancelarije Premijera i ministarstva (22.03.2011), i član 38 stav 6 Pravilnik rada Vlade br. 09/2011 (službeni glasnik br. 15,12.09.2011), izdaje: |
| **UDHËZIM ADMINISTRATIV**<br><br>**Aplikimi i pagesave të studentëve në universitetet publike** | **ADMINISTRATIVE INSTRUCTION**<br><br>**Application of students' payment in public universities** | **ADMINISTRATIVNU ZREDBU**<br><br>**Aplikacija studentskih isplata na državnim univerzitetima** |
| **NUMËR:** 17/2014<br>**DATË :** 06.05.2014 | **NUMBER:**<br>**DATE:** | **BROJ:**<br>**DATUM:** |
| **Neni 1**<br>**Qëllimi** | **Article 1**<br>**The purpose** | **Član 1**<br>**Cilj** |
| 1. Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është që të përcaktojë pagesat për shkollim dhe tarifat tjera që paguhen nga studentët të cilët studiojnë në Universitetin e Prishtinës për vitin akademik 2014/2015. | 1. The purpose of this Administrative instruction is to determine payments for education and other fees that are paid from students, who study in University of Prishtina for academic year 2014/2015. | 1. Cilj ove administrativne uredbe je da određuje isplate za školovanje i druge tarife koje se isplačuju od studenata koji studiraju na Univerzitet u Prištini za akademsku 2014/2015 godinu. |
| 2. Mjetet e grumbulluara nga pagesat studentëve do të shfrytëzohen për tri qëllime kryesore: | 2. Funds collected from students' payment will be used for three main purposes: | 2. Sakupljena sredstva iz studentskih isplata biće koriščene za tri glavne svrhe: |

| | | |
|---|---|---|
| 2.1. Bursa për studentë të dalluar, punë laboratorike, praktike profesionale, vizita studimore;<br>2.2. Përmirësimi i kushteve të studimeve në Universitet dhe<br>2.3. Pagesa për aktivitete brenda Universitetit. | 2.1. Scholarships for distinguish students, laboratory works, practice professional, study visits.<br>2.2. Improvement of study conditions in University and<br>2.3. Payment for activities within University. | 2.1.Stipendije za odlikovane studente, laboratorske radnje, profesionalnu praksu, studijske posete<br>2.2.Poboljšanje uslova studija na Univerzitet i<br>2.3.Isplate za aktivnosti unutar univerziteta. |
| **Neni 2**<br>**Tarifat e shkollimit dhe pagesat administrative** | **Article 2**<br>**Tuition fees and administrative payments** | **Član 2**<br>**Tarife školovanja i administrativne isplate** |
| 1. Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në universitetet publike vitin e parë të studimeve e kanë falas. | 1. Students, citizens of the Republic of Kosova beginning studies in public universities, have their first year free of charge. | 1. Studenti državljani Republike Kosova koji počinju da studiranju na javnim univerzitetima prvu godinu studije biće besplatno. |
| 2. Familjet kosovare që kanë më tepër se një student në universitete do të paguajnë vetëm për një student, ndërsa për studentët tjerë nuk do të paguajnë. Të gjithë fëmijët tjerë student të rinjë do të studiojnë pa pagesë. | 2. Kosovar families having more than one student in universities will pay only for one student, whereas other students will not be asked to pay. All other children, young students will study free of charge. | 2. Porodice sa Kosova koje imaju više od jednog studenta platiće samo jedan student, dok za ostale studente neće se vršiti uplata. Sva druga deca mladi studenti studiraće besplatno. |
| 3. Universitetet Publike do të realizojnë pagesat për shkollim dhe pagesat administrative nga studentët për vitin akademik 2014/2015 dhe atë: | 3. Public Universities will implement tuition payments and administrative payments from students' for the academic year 2014/2015 and that: | 3. Javni univerziteti realizovaće isplate za školovanje i administrativne isplate iz studenata za akademsku 2014/2015 godinu: |
| 3.1. Pagesat për semestër për studentët e rregullt, në nivelin "Bachelor" 25 €; | 3.1. Payments per semester for regular students, in "Bachelor" level 25 €; | 3.1. Isplate za semestar za redovne studente, nivo "Bachelor" 25 €; |
| 3.2. Pagesa për semestër për studenëtët me korrespondencë në nivelin "Bachelor"125€; | 3.2. Payments per semester for part-time students in "Bachelor" level 125 €; | 3.2.Ispalte za semestar za vanredne studente nivo "Bachelor" 125€; |
| 3.3. Pagesa për semestër për studimet Master-shkencore 150 €; | 3.3. Payment per semester for Master scientific studies 150 €; | 3.3. Isplate za semestar za studente "Master"- nauke 150€; |
| 3.3.1. Pagesa për mbrojtjen e | 3.3.1. Payment for protection of | 3.3.1. Deo za odbtranu diplome studije |

| | | |
|---|---|---|
| diplomës të studimeve Master-shkencore 100 €; | Master-scientific study diploma 100 €; | "Master" 100€; |
| 3.4. Pagesa për semestër për studime Master profesional 150 €;<br><br>3.4.1. Pagesa për mbrojtjen e temës Master profesional 100 €<br><br>3.5. Pagesa për mbrojtjen e temës së Magjistraturës 100 €;<br><br>3.6. Pagesa për semestër për studimet e doktoraturës 500 €<br><br>3.6.1. Pagesa për mbrojtjen e disertacionit të doktoraturës 300 €. | 3.4. Payment per semester for Master professional studies 150 €;<br><br>3.4.1. Payment for topic protection, professional Master 100 €;<br><br>3.5. Payment for protection of Magistrate topic € 100;<br><br>3.5. Payment per semester for Doctoral studies 500 €;<br><br>3.6.1. Payment for the protection of doctoral dissertation 300 €; | 3.4. Isplata za semestar za Master studije profesional 150€;<br><br>3.4.1. Isplata za odbranu teme Master profesional 100€;<br><br>3.5. Isplata za odbranu teme Magistrature 200€.<br><br>3.6. Isplate za semestar studije doktorata 500 €<br><br>3.6.1. Isplata za odbranu disertacije doktorata 300 €. |
| **Neni 3**<br>**Pagesat administrative**<br><br>1. Studentët paguajnë edhe për këto shërbime administrative:<br><br>1.1. Për provim pranues 2.5 €;<br><br>1.2. Për secilin provim plotësues për regjistrimin e studimeve Master 5 €;<br><br>1.3. Për provimin e studimeve Master 2.5€;<br><br>1.4. Për certifikatë të notave 2.5 €;<br><br>1.5. Për certifikatë të diplomës 5 €; | **Article 3**<br>**Administrative payments**<br><br>1. Students pay also these administrative services:<br><br>1.1 For the entrance exam 2.5 €;<br><br>1.2 For each additional exam for enrolment of Master studies 5 €;<br><br>1.3 For the exam of Master studies 2.5 €;<br><br>1.4 For the grade certificate 2.5 €;<br><br>1.5 For diploma certificate 5 €; | **Član 3**<br>**Administrativne isplate**<br><br>1. Studenti isplačuju i ove administrativne usluge:<br><br>1.1. Za prijemni ispit 2.5 €<br><br>1.2. Za svaki dopunski ispit za upisivanje studija Master 5€<br><br>1.3. Za ispit studije Master 2. 5 €<br><br>1.4. Za sertifikat ocena 2.5 €<br><br>1.5. Za diplomski sertifikat 5€ |

| | | |
|---|---|---|
| 1.6. Për indeks duplikat 25 €;<br><br>1.7. Për secilin provim të pranuar në rastin e transferimeve 0.50 €;<br><br>1.8. Për diplomë 5 €;<br><br>1.9. Për diplomë duplikat 25 €;<br><br>1.10. Për ndërrim fakulteti-departamenti 25 €. | 1.6 For duplicate index 25 €;<br><br>1.7 For each accepted exam in case of transfers 0.50 €;<br><br>1.8 For diploma 5 €;<br><br>1.9 For duplicate diploma 25 €;<br><br>1.10. For change of faculty-department 25 €. | 1.6. Za indeks duplikat 25€<br><br>1.7. Za svaki ispit primljen u slučaju Transfera 0.5€;<br><br>1.8. Za diplomu 5€<br><br>1.9. za diplomu duplikat 25€<br><br>1.10. Za izmenu fakulteta-departamenta 25€. |
| **Neni 4**<br>**Afati** | **Article 4**<br>**Deadline** | **Član 4**<br>**Rok** |
| 1. Këto pagesa për shkollim dhe pagesa administrative të caktuara në këtë Udhëzim administrativ vlejnë për vitin akademik 2014/2015.<br><br>2. Të gjitha pagesat do të rishikohen për çdo vit nga MASHT-i, në konsultim me MEF dhe Universitetin. | 1. These tuition payments and administrative payments set in this Administrative instruction are valid for academic year 2014/2014.<br><br>2. All payments will be reviewed for each year from MEST, in consultation with MEF and University. | 1. Ove isplate za školovanje i administrativne isplate određene ovom Administrativnom uredbom važe za akademsku 2014/2015 godinu.<br><br>2. Sve isplate biće pregledane svake godine od MONT-a, u konsultaciji sa MRF-om i univerzitetom. |
| **Neni 5**<br>**Përjashtimet** | **Article 5**<br>**Exceptions** | **Član 5**<br>**Izuizeci** |
| 1. Studentët të cilët nuk kanë mundësi ekonomike të financojnë studimet e tyre duhet të paraqiten për asistencë. Për të shfrytëzuar këtë asistencë do të përpilohet udhëzimi administrativ nga MASHT-i.<br>2. MASHT-i do të nxjerr Udhëzim administrativ lidhur me krijimin dhe funksionimin e skemës për dhënie të bursave studentëve te dalluar. | 1. Students who do not have economical opportunity to finance their studies should apply for assistance. To use this assistance will be compiled administrative instruction from MEST.<br>2. MEST will issue Administrative Instruction with establishment and functioning of scheme for granting of scholarships for distinguished students. | 1. Studenti koji nemaju ekonomske mogučnosti da finansiraju svoje studije trebaju da predstavljaju za asistenciju. Da bi koristili ovu asistenciju biće sastavljena administrativna uredba od MONT-a.<br>2. MONT izdaće administrativnu uredbu u vezi stvaranja i funksionisanja šeme za izdavanje stipendija posebnim studentima. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 6**<br>**Mënyra e pagesës** | **Article 6**<br>**Manner of payment** | **Član 6**<br>**Način isplačanja** |
| 1. Pagesat nga studentët do të bëhen në cilëndo bankë komerciale në Kosovë në llogari të Buxhetit të Republikës së Kosovës-Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë-Universiteti i Prishtinës. | 1. Payments from students will be done in each commercial bank in Kosovo into account the budget of the Republic of Kosovo – Ministry of Education, Science and Technology – University of Prishtina. | 1. Isplate od strane studenata se vrši u bilo kojoj komercijalnoj banci na Kosovu u žiroračun Budžeta Republike Kosova-Ministarstvu obrazovanja, nauke i tehnologije-Univerziteta u Prištini. |
| 2. Studenti është i obliguar ta dëshmoj me dëftesë për pagesën e kryer. | 2. The student is obliged to attest with receipt the completed payment. | 2. Student je dužan da dokaže potvrdom za izvršenu isplatu. |
| **Neni 7**<br>**Dispozitat shfuqizuese** | **Article 7**<br>**Repealing provisions** | **Član 7**<br>**Odredbe ukidanja** |
| Me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi administrativ shfuqizohet Udhëzimi administrativ nr. 21/2012 dt.22.10.2012. | With entry into force of this Administrative Instruction is repealed Administrative Instruction no. 21/2012 dt.22.10.2012 | Stupanjem na snagu ove administrativne uredbe stavlja se van snage administrativna uredba br. 21/2012 dt.22.10.2012 |
| **Neni 8**<br>**Hyrja në fuqi** | **Article**<br>**Entry into force** | **Član 8**<br>**Stupanje na snagu** |
| Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij . | This Administrative instruction enters into force on the day of its signature. | Ova administrativna uredba stupa na snagu danom potpisivanja. |
| **Prof. dr. Ramë Buja, minister** | **Prof, dr. Ramë Buja, minister** | **Prof, dr. Ramë Buja, ministar** |